

22.01.2022
Ora 12:33

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për një shtesë në vendimin nr. 3, datë 6.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**


- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ Y.Merkaj, M.Koja

Parti Politike: PD (I.Sefa, M.Logu), LSI (A.Kaziaj)

OJQ: KRIK

Znj. I. Nano: Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator, e cila është njoftuar zyrtarisht në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Jemi rikthyer një periudhe zgjedhore, duke patur parasysh dekretin e Presidentit të Republikës, për shpalljen e zgjedhjeve të pjesshme në 6 bashki të vendit. Kjo mbledhje në rendin e ditës ka dy projektakte. Projektakti i parë është “Për një shtesë në vendimin nr.3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores, për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.22.01.2022*

të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”. Projektakti i dytë është një projektvendim, “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022. Të pranishëm në mbledhje janë të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përfaqësues të tjerë të administratës. Ndërkohë në vendin ku qëndrojnë përfaqësuesit e partive politike, shoh përfaqësuesin e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, zotin Kaziaj, janë dhe dy përfaqësues, zoti Merkaj, janë përfaqësues të ndonjë subjekti të ri?

Z. Y. Merkaj: Dje Partia Demokratike ka sjellë një shkresë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ku na bën me dije që përfaqësuesit e saj në KQZ do të jenë zoti Indrit Sefa dhe Marash Logu.

Znj. I. Nano: Zoti Sefa, zoti Logu, mirë se vini në mbledhjen e Komisionit Rregullator! Për të saktësuar cili është përfaqësuesi dhe zëvendësuesi?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Unë jam Indrit Sefa, jam përfaqësues i Partisë Demokratike, sekretar i çështjeve ligjore dhe zgjedhore pranë subjektit zgjedhor Partia Demokratike. Zoti Logu është zëvendësuesi, sipas autorizimit të paraqitur nga Partia Demokratike. E nderuar, punë të mbarë! Unë jam përfaqësues i Partisë Demokratike për vazhdimin, faleminderit!

Znj. I. Nano: Atëherë fillojmë mbledhjen. Pas dy akteve që unë prezantova si akte për shqyrtim në rendin e ditës, më lejoni t’u drejtohem pjesëmarrësve nëse ka ndonjë çështje jashtë rendit të ditës që dëshirojmë ta diskutojmë? Ju lutem, anëtarët e komisionit, çështje jashtë rendit të ditës? Përfaqësuesit e partive

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.22.01.2022*

politike nëse kanë diçka jashtë rendit të ditës? Faleminderit! Atëherë fillojmë me rendin e ditës. Në rendin e ditës së pari kemi projektvendimin “Për një shtesë të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, për miratimin e rregullores, për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”. Zoti Sekretar i Përgjithshëm, ju lutem!

Z. Y. Merkaj: Me vendimin nr. 3, datë 06.11.2020 Komisioni Rregullator ka miratuar mënyrën e organizimit dhe funksionimit të zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Në nenin 9 ka përcaktuar se kundër akteve të Komisionerit lejohet ankim në rrugë administrative në KAS, nga palët që demonstrojnë interes të ligjshëm për çështjen dhe afati i ankimit kundër këtyre vendimeve është 3 ditë. Duke qenë se nuk është parashikuar tek vendimi rregullues i KAS-it për zgjedhjet e parakohshme, ose të pjesshme, kemi propozuar që afati i ankimit, duke pasur parasysh edhe periudhën e shkurtër kohore që zhvillohen zgjedhjet e pjesshme, që është 30-45 ditë, kemi propozuar që në këtë nen të shtohet dhe të bëhet “në rast të zgjedhjeve të parakohshme apo të pjesshme afati i ankimit 3 ditë të bëhet brenda 24 orësh”, në të gjitha nenet ku është parashikuar afati i ankimit 3 ditë, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Atëherë për të saktësuar propozimin. Propozimi lidhet me një shtesë në pikën 1, 7 dhe 8 të nenit 9. Në nenin 9, pika 1 bëhet fjalë për ankimin, të drejtën e ankimit që çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit, kanë kundër vendimeve të KZAZ-së që çënojnë interesat e tyre të ligjshëm. Në rregullore është 3 ditë, propozohet të shtohet afati 24 orë për ankimin në rastin e zgjedhjeve të parakohshme apo të pjesshme. Në pikën 7 gjithashtu bëhet fjalë për të drejtën e ankimit në KAS kundër vendimeve që refuzojnë regjistrimin e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.22.01.2022*

vëzhguesve për organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja. Në pikën 8 gjithashtu bëhet fjalë për afatin e ankimit nga 3 ditë në 24 orë, gjithmonë për zgjedhjet e pjesshme apo të parakohshme kundër akteve të Komisionerit nga palët që demonstronë një interes të ligjshëm për çështjen objekt hetimi. Pra, këto janë 3 ndërhyrjet që kërkohet të bëhen gjithmonë vetëm për këtë kategori zgjedhjesh. Ndërsa për zgjedhje të zakonshme, qoftë zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin, qoftë zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore, afatet janë po ato që janë miratuar në rregulloren e KAS-it. Ka diçka për të diskutuar në parim ose konkretisht për projektaktin? Po zoti Çaka!

Z. D. Çaka: Faleminderit zonja Kryetare! Në parim jam dakord me draftin e sjellë nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por doja të bëja një propozim. Duke qenë se këtu në akt bëhet fjalë për zgjedhjet e parakohshme apo të pjesshme, duhet theksuar që jo detyrimisht zgjedhjet e parakohshme janë njëkohësisht edhe të pjesshme. Prandaj duke qenë se ato mund të jenë, pra mund të kemi dhe zgjedhje të parakohshme dhe të pjesshme veç, doja të bëja një propozim që mbas lidhëzës “dhe”, të shtohet edhe lidhëza “ose” në mënyrë që kjo dispozitë të mund të zbatohet në të dy rastet kumulative ose në secilin prej tyre veç e veç. Pra, ose në zgjedhje të parakohshme apo dhe ato të pjesshme, dhe do doja që kjo dispozitë të ishte “për zgjedhjet e parakohshme dhe slash ose të pjesshme, afati i ankimit 3 ditë i përcaktuar në pikat 1, 7 dhe 8 të këtij neni bëhet 24 orë”, faleminderit!


Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çaka! Propozim tjetër? Atëherë votojmë... Projektvendimi ka 3 pika. Pika e parë votojmë propozimin e zotit Çaka.

Kush është dakord me shtesën e propozuar?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.22.01.2022*

Me 5 vota pro, miratohet propozimi i zotit Çaka!

Rrjedhimisht miratohet pika 1 e projektvendimit sipas propozimit të zotit Çaka. Pika 2, ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet menjëherë në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Pika 3 kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Do t'i lutesha administratës që për këtë vendim dhe për të tjerat, thjesht të saktësojnë shprehjen "Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë". Atëherë e miratojmë në tërësi projektaktin.

Kush është dakord?


Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratuam vendimin për një shtesë të vendimit nr.3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, "Për miratimin e rregullores për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimin të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve".

Vendimi nr. 1

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



22.01.2022
Ora 12:44

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar, në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rogozhinë dhe Lushnje, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• Komisioni Rregullator:

- | | | |
|------------|-----------|-------------------------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Staf | KQZ | Y.Merkaj, M.Koja |
| Parti | Politike: | PD (I.Sefa, M.Logu), LSI (A.Kaziaj) |
| OJQ: | | KRIK |


Znj. I. Nano: Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës. Kemi projektvendimin e dytë. Janë disa afate procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme të dekretuara nga Presidenti i Republikës, për kryetar të bashkisë në 6 bashki të vendit. Pra, për zgjedhjet që do të zhvillohen në 6 mars. Sekretari i Përgjithshëm nëse dëshiron të na flasë për nevojën e këtij akti dhe mënyrën si arritëm deri këtu, në këtë propozim.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.22.01.2022*

Z. Y. Merkaj: Duke iu referuar nenit 2, 93 dhe 115 të Kushtetutës si dhe nenit 10 të Kodit Zgjedhor, Presidenti i Republikës me dekretin nr. 13438, datë 20.01.2022, ka caktuar datën 6 Mars 2022 për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje. Referuar nenit 20, pika 1, gërma “a” e Kodit Zgjedhor, parashikohet kompetenca e Komisionit Rregullator për miratimin e projektakteve, për rregullat e detajuara, për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje. Në zbatim të detyrimit të Kodit Zgjedhor, në këtë projektvendim kemi parashikuar të gjitha afatet proceduriale, të cilat janë të reduktuara në kohë dhe respektojnë kronologjinë e veprimeve të cilat parashikohen në Kodin Zgjedhor për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë që përmenda më sipër. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, ku janë përcaktuar të gjitha afatet për zhvillimin e procedurave për zhvillimin e zgjedhjeve. Është në kompetencën tuaj për ta miratuar, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Atëherë sikundër anëtarët e komisionit, por dhe përfaqësuesit e partive politike janë informuar kemi një projektvendim, i cili vendos disa afate proceduriale dhe vendos.., do ta quaj një *road map* të asaj se çfarë duhet të bëhet, duke filluar nga dita e sotme lidhur me këto zgjedhje. Duke përfshirë këtu si detyrimet e institucioneve për raportime, detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për të hartuar listën e zgjedhjeve, detyrimet e njësisë të vetëqeverisjes vendore për caktimin e qendrave të votimit, vendeve të numërimit të votave, e të tjera me radhë. Gjithashtu dhe afate që lidhen me paraqitjen qoftë të dokumentacionit, qoftë anëtarëve për KZAZ-të pikërisht në këto bashki që do të zhvillohen zgjedhjet. E konsideroj një akt të rëndësishëm sepse ky na dëshmon atë se çdo të bëhet duke nisur nga nesër, pra gjithë këto

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.22.01.2022*

subjekte që unë i prezantova deri tani. Fillojmë atëherë diskutimin për aktin, diskutimi në parim njëherë, nëse kolegët kanë diçka ose përfaqësuesit e partive politike, lidhur me aktin në parim? Po, zoti Sefa!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Normalisht ne jemi koshientë që jemi në një situatë të tillë dhe normalisht nuk kemi shumë kohë për organizimin e zgjedhjeve të pjesshme, por gjithsesi normalisht ka nevojë për ndërhyrje në afatet për regjistrimin e kandidatëve dhe për organizimin e zgjedhjeve. Në përgjithësi jemi dakord me projektvendimin, ndërkohë që kemi disa objeksione në lidhje me datat specifike për të cilat në nenet përkatëse do mbajmë dhe qëndrimin përkatës.

Znj. I. Nano: Në rregull, faleminderit! Zoti Kaziaj!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Faleminderit zonja Nano! E nderuar Kryetare, të nderuar anëtarë të Komisionit Rregullator! Ju urojmë një vit të mbarë dhe një punë të themi, të vështirë e keni, por keni dhënë provë që jeni të palodhshëm dhe e keni bërë me përkushtim, të paktën për zgjedhjet e kaluara. Përsa i përket pjesës së aktit, siç e thatë edhe ju, ne jemi njohur me të nëpërmjet komunikimit zyrtar të bërë nga administrata e KQZ-së. Përsa i përket përmbajtjes së tij e gjejmë atë, të themi dhe ky është qëndrimi zyrtar i subjektit politik që unë përfaqësoj, e gjejmë objektivisht në përputhje me ato që janë dispozita përkatëse që ligjvënësi ka parashikuar në Kodin Zgjedhor. Duke qenë se jemi një subjekt politik që kërkojmë transparencë dhe jemi pro barazisë së armëve, duke qenë se në zgjedhjet vendore të parakohshme dhe të pjesshme për këto 6 bashki, janë shumë subjekte që marrin pjesë, qoftë subjekte politike, qoftë komitete nismëtare, koalicione zgjedhore apo dhe kandidatë të pavarur. Dispozitat e këtij projektvendimi pasqyrojnë qartazi të themi, afatet procedurale të natyrës objektive, kështu që jemi parimisht dakord me aktin.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Kaziaj! Atëherë kalojmë në votimin në parim të projektaktit.

Kolegë, kush është dakord me projektvendimin?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka


Me 5 vota pro miratohet projektvendimi në parim!

Kalojmë nen për nen ose pikë për pikë. Projektvendimi ka 18 pika, përveç dy të fundit që janë hyrja në fuqi, publikimi dhe e drejta e ankimit, gjithë të tjerat lidhen me afatet apo detyrat që u caktohen subjekteve të ndryshme, qoftë subjekteve politike, subjekteve zgjedhore, por dhe institucioneve publike qendrore apo vendore në raport me këtë periudhë zgjedhore dhe më pas edhe posaçërisht me fushatën zgjedhore. Duke qenë që të gjitha palët janë njohur me projektaktin, po kërkoj dhe mendimin e kolegëve. Dëshironi që t'i lexoj secilën pikë një nga një, apo të vlerësojmë një nga një se cilën pikë dhe të votojmë, kuptohet edhe nëse ka propozime për ndryshime apo për shtesa.

Z. M. Çakaj: Mund të vazhdoni, domethënë parimisht të dyja palët, përfaqësues të subjekteve politike të akredituar në KQZ, deklaruan që janë njohur me përmbajtjen e projektaktit. Kështu që edhe për ekonomi kohe mund të vazhdojmë në çdo pikë, nëse ka ndërhyrje, sigurisht me dakordësinë e tyre, nëse ka ndërhyrje, japim propozimin konkrete, e diskutojmë dhe e dakordësojmë.

Znj. I. Nano: Mirë, atëherë fillojmë me pikën 1, e cila lidhet me detyrimin për raportim qoftë të bashkive, në të cilat do të kryhen zgjedhjet e pjeshme, institucioneve të tyre të varësisë, institucionet publike qendrore, organet e tyre të varësisë, degëve të tyre vendore apo agjencive të ndërmarrjeve shtetërore për të raportuar veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë nga 31

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.22.01.2022*

janari deri në 6 mars. Për të shpjeguar, data 31 janar është vendosur në këtë pikë për shkak të parashikimeve të Kodit Zgjedhor dhe të një vendimi të mëhershëm të Komisionit Rregullator. Pra, veprimtaria duhet të raportohet 5 ditë para zhvillimit të saj. Nëse ne e miratojmë sot që është ditë e shtunë këtë akt, atëherë do të duhet të njoftohen institucionet për këtë detyrim, do duhen caktuar personat përgjegjës dhe pastaj vlerësohet raportimi 5 ditor. Kemi diçka për pikën 1, nëse ka, kolegët por edhe përfaqësuesit e partive politike parlamentare?

Atëherë kalojmë në votimin e pikës 1, kush është dakord, kolegë?

Pro: 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet pika 1!

Pika 2, fillimi i fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme në 6 bashki, për zgjedhjet që janë dekretuar nga Presidenti i Republikës, fillojnë në datën 19 shkurt 2022, edhe caktimi i kësaj date është dy javë nga zhvillimi i zgjedhjeve, duke patur parasysh që fushata zgjedhore për zgjedhjet e rregullta që dekretohen 9 muaj më herët, është 1 muaj, në këto zgjedhje ku e gjithë periudha zgjedhore është 45 ditë, është vendosur, ose është propozuar më mirë të themi, sepse vendimmarrja është një moment më vonë, është propozuar ky afat, nga 19 shkurti. Kemi propozime për shtesa, ndryshime, komente lidhur me këtë pikë? Zoti Sefa, po!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Faleminderit! Duke pasur në konsideratë që këto janë zgjedhje vendore dhe bëhen për administrimin e njësive vendore, unë mendoj që koha e lënë prej dy javësh, praktikisht nuk është as dy javë, duke konsideruar është 13 ditë, duke konsideruar heshtjen zgjedhore. Unë mendoj që është shumë e pakët zonja Kryetare e komisionit, për faktin e vetëm se ne kemi të gjithë mundësinë objektive për të realizuar një kohë më të gjatë fushate zgjedhore. Ne pretendojmë, dhe ne propozojmë që data 7 shkurt, të jetë data e

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.22.01.2022*

fillimit e fushatës zgjedhore, për sa kohë që kandidatët duan të kenë mundësinë për të shprehur një projekt për qytetarët, një projekt administrimi, projekte konkrete në lidhje me këta, në lidhje me mirëqeverisjen e njësisë vendore. Ndaj mendojmë që një fushatë kaq e shkurtër zgjedhore nuk do t'i vinte në ndihmë procesit. Edhe datat e tjera që janë paraqitur në këtë projektvendim janë data që mendoj që data 7 shkurt do të ishte mëse e mjaftueshme për nisjen e fushatës zgjedhore dhe për t'i dhënë mundësinë kandidatëve që të krijojnë ekipet, të krijojnë idetë, të shpalosin ato dhe nuk shoh ndonjë pengesë në këtë pikë. Pastaj administrimi zgjedhor mund të funksionojë dhe paralel me nisjen e fushatës zgjedhore dhe kjo nuk është pengesë në këtë kuptim. Ndaj unë mendoj që kjo lënia e nisjes së fushatës zgjedhore për një afat dy javor është shumë pak dhe mendoj që kandidatët do kishin nevojë për më shumë, për më shumë akses në komunikim me qytetarët. Mendoj që ky komision duhet ta rishikojë edhe njëherë përcaktimin e kësaj date, pasi mendoj që në asnjë moment nuk bie ndesh edhe me organizimin zgjedhor dhe detyrat e KQZ-së në terren për administrimin cilësor të zgjedhjeve, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Sefa! Po, zoti Çaka! Më fal zoti Çaka, në këtë moment kemi vetëm një propozim që është data 7 shkurt, data e fillimit të fushatës zgjedhore. Propozimi juaj ose komenti juaj?

Z. D. Çaka: Kisha një koment, më shumë në formën e pyetjes për përfaqësuesin e partisë politike. Me të drejtë ju kërkoni një kohë më të madhe për kandidatët dhe thoni që data 7 do të ishte data perfekte në mënyrë që kandidatët të shpalosin dhe platformën e tyre. Por duke parë në tërësi aktin e sjellë nga administrata, duke parë afatet, duke parë detyrimet që ka kodi për plotësimin e tyre, kandidatët minimalisht nuk mundet të regjistrohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përpara datës 12, ose 13 shkurt në mos gaboj. Pra, dhe në qoftë se ne do merrnim

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.22.01.2022*

për bazë propozimin tuaj për datën 7 shkurt, do të hapnim një fushatë zgjedhore pa pasur kandidatë të regjistruar, sepse duhet të kemi parasysh që afatet në këto momente janë super të ngushta dhe kërkojnë fillimisht regjistrimin e partive ose të komiteteve nismëtare, pastaj të kandidatëve, verifikimin e dokumentacionit të tyre, mundësinë e kthimit të dokumentacionit, kohën që kërkon Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vendimmarrjen e Komisionerit Shtetëror dhe nuk mendoni që ky afat është shumë i gjerë dhe do ketë mundësinë që të kemi një fushatë pa kandidatë në ato data?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Ne mendojmë që, në të gjithë këtë projektvendim ka momente dhe ka mundësi që ne t'i ngushtojmë afatet, sepse siç jeni dhe ju në dijeni, partitë politike janë koshiente për situatën në të cilën ndodhet dhe për kohën e shtrënguar në të cilën po bëhen këto zgjedhje. Ne mendojmë që edhe subjektet zgjedhore kanë mundësi, i kanë aftësitë dhe njerëzit për mos të zgjatur shumë në kohë për zgjedhjen e administratës zgjedhore. Kam në konsideratë KZAZ-të, anëtarët e KZAZ-ve, anëtarët e QV-ve e me radhë. Kjo është një sakrificë edhe nga ana juaj, por edhe nga ana jonë si subjekte zgjedhore, të cilët marrim përsipër dhe detyrimet tona, t'i përmbushim brenda një kohe sa më të shkurtër për të kursyer kohë dhe kohës së vendimmarrjes nga ana e Komisionerit. Në këtë formë ne i japim mundësi kandidatëve, sepse në fund të fundit këto zgjedhje janë për qytetarët dhe ne duam që qytetarët të kenë një mundësi alternative. Zgjedhjet të kenë alternativë të përcaktuar qartë dhe jo të zgjidhen në bazë të preferencave partiake, sepse këto janë zgjedhje vendore dhe kjo është shumë e rëndësishme që kandidatët të kenë projekte për qytetarët. Ndaj dhe unë mendoj që kërkesa jonë është në frymën e kërkesave që do kemi në vazhdim për shkurtimin e afateve të paraqitjes së kandidaturave. Ne deri tani nuk kemi dijeni për faktin që mund të ngrihen komisione nga qytetarët për kandidatura të pavarura apo jo, por gjithësesi në bazë të ligjit ne do i lëmë dhe atyre afat dhe kjo është

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

normale. Por, afatet në konceptin tim dhe ashtu siç ne e logjikojmë këtë, duhet të jenë sa më të ngushta. Për shembull unë shoh këtu që Komisioneri do 48 orë kohë për të verifikuar dhe për të miratuar anëtarët e KZAZ-së, është kohë shumë e tepërt, nuk ka nevojë, në qoftë se partitë politike i sjellin...

Znj. I. Nano: Më fal, cilës pike i referoheni, ju lutem?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Është tek pika 4.

Znj. I. Nano: Tek pika 4.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Domethënë thotë “jo më vonë se nga data 25, partitë politike sjellin propozimet për anëtar të KZAZ-së” dhe Komisioneri “jo më vonë se data 27”. Këto janë dy ditë të humbura kot. Unë mendoj që 24 orë janë mjaftueshëm, sepse siç jeni dhe ju në dijeni, administrata zgjedhore, propozuar nga partitë politike është e njëjta. Ne tani sa e kaluam një zgjedhje, para, as një vit nuk e ka mbushur. Praktikisht do jenë të njëjtët persona, të njëjtët njerëz që kanë bërë dhe administrimin zgjedhor të mëparshëm.

Znj. I. Nano: Zoti Sefa, nëse më lejoni dhe pastaj zoti Merkaj! Duke qenë që ju propozimin e bëtë fillimisht për fushatën zgjedhore, për fillimin, datën e fillimit, por sigurisht që ajo implikon edhe gjithë afatet e tjera që janë pararendëse.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Logjika jonë është jo se ne po themi data 7 dhe nuk lëvizim. Mund të jetë dhe data 12, ose mund të jetë dhe data 10. Por ideja është ta afrojmë datën e fushatës elektorale. Ne mendojmë që data 7 është e mundshme.

Znj. I. Nano: Besoj që që të gjithë kemi të njëjtin shqetësim. Edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si organi përgjegjës për administrimin e zgjedhjeve, edhe partitë politike dhe gjithë subjektet zgjedhore që do të regjistrohen për këto zgjedhje. Por të paktën një gjë e dimë të gjithë që kemi shumë pak kohë në dispozicion dhe nëse e shihni në afate të tjera, të parashikuara në pikat e tjera ne nuk kemi vënë afate fikse. Pra, ne themi jo më shumë se 24 orë, ose brenda 24 orëve, jo më shumë se 48 orë, sepse duke vënë afate fikse është problem, mund të shkelet afati. Ndërsa kur vendos një afat të shprehur në këtë mënyrë, mund t'i japësh kohë vetes, por gjithsesi ke një afat maksimal. Pra, mund të përfitosh kohë por kjo është në varësi të zhvillimeve që vijnë. Megjithatë, brenda aktit janë disa afate që janë afate ligjore, të cilat nuk mund të shkelen. Pra, ato që ligji i ka përcaktuar për zgjedhjet pa pasur parasysh nëse janë zgjedhje të përgjithshme, apo zgjedhje të pjesshme, apo zgjedhje të parakohshme. Kështu që nëse nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kishte diçka zoti Merkaj, pak më herët apo zonja Koja! Sikur kishit një koment?

Z. Y. Merkaj: Jo thjesht doja t'i sqaroja më tepër përfaqësuesit të Partisë Demokratike se ne këtë afat e kemi përcaktuar duke pasur parasysh që janë 13 KZAZ, me 7 veta i bie rreth 91 ose 100 veta. Do të bëhet verifikimi i këtyre 100 personave. Nuk është vetëm administrata e KQZ-së, por është dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve që do të bëjë verifikimin. Gjithashtu do dhe një kohë trajnimi, për t'u trajnuar. Ne kemi marrë, e kemi supozuar se këta persona do të jenë të patrajnuar, në qoftë se ata do jenë të njëjtat parti, do të sjellin të njëjtët persona, akoma më mirë, por ne e kemi parashikuar, e kemi konceptuar aktin sikur këta persona të jenë të patrajnuar. Duhet një kohë të paktën 24 orë e kemi parashikuar që të trajnohen për gjithë procesin. Prandaj kemi caktuar këtë afat 48 orë, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Po zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Dëgjova shqetësimin e zotit Sefa, i cili me të drejtë e ngre këtë shqetësim të mungesës së konsiderueshme të kohës për të shpалosur programet politike. Ne e dimë të gjithë që kjo në kushtet e këtyre zgjedhjeve del jashtë ritmit me të cilin eventualisht jemi mësuar për çdo zgjedhje. Pra, shpалosja e programeve në më shumë sesa dy javë që ne e dimë që shkon 30 ditë. Jemi koshientë të gjithë se në ç'rrethana po bëhen këto zgjedhje dhe sesi janë të limituara afatet, bashkë me ju kolegë e kemi trajtuar edhe më herët këtë shqetësim që sapo shprehu zoti Sefa, për t'u dhënë mundësi subjekteve politike, por edhe kandidatëve, individëve të pavarur, të cilët do marrin cilësimin si kandidat, që ta kenë këtë mundësi. Pra, të dhënies së mundësisë zgjedhësve që të njihen me alternativën më të mirë, pra me programet e tyre respektive. Por, nga ana tjetër jemi të kushtëzuar nga afatet ligjore, të cilat sado ne të kemi dëshirën subjektive do priremi që t'i respektojmë dhe nuk mund t'i anashkalojmë. Në këto rrethana i bie që edhe dëshira e madhe për ta spostuar këtë afat, duket sikur do cedonte procesin në tërësi, pasi siç e dimë procesi ka një sërë hallkash, etapash procedurale verifikimi, të cilat nuk varen vetëm nga KQZ-ja. Pra, varen nga struktura të tjera të cilat angazhohen në këtë proces, si Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, më pas janë afatet që duhen respektivisht për përzgjedhjen e gjithë strukturave *micro* dhe kjo besoj nuk na nxit tek iniciativa, ose ajo sakrificë që përmendi zoti Sefa, që megjithë dëshirën do të sakrifikoja. Por, duke qenë që afatet ligjore janë kaq strikte dhe kaq decizive për të dalë një proces legjitim, të themi, sepse kandidaturat duhen verifikuar dhe që të verifikohen ato kalojnë në disa filtra dhe hallka, si brenda KQZ-së, por njëkohësisht dhe jashtë KQZ-së. Kështu që, mbështes parimisht le të them, shqetësimin e zotit Sefa, por realisht nuk di se ku mund ta gjejmë hapësirën për t'u dhënë më shumë hapësirë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.22.01.2022*


kandidatëve ose subjekteve zgjedhore për të pasur kohën e mjaftueshme për një shpalesje programesh, më shumë sesa dy javë.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Ja, kam dhe diçka pastaj zonja Koja, Drejtoresha e Drejtorisë Juridike. Atëherë nëse e shohim aktin me vëmendje, akti parashikon disa procese që ndodhin në kohë të caktuar dhe një proces shumë i rëndësishëm është ngritja e KZAZ-ve. Afati për ngritjen e KZAZ-ve është afat ligjor. Afati për paraqitjen e anëtarëve nga partitë politike është afat ligjor dhe gjithë të tjerat vijnë pas, janë procese që ndodhin më pas. Pra, pa patur të ngritura KZAZ-të nuk mund të kemi procese të tjera, prandaj mendoj që akti ka një logjikë të mirë, të brendshme, sa i përket rradhës të punëve, rradhës së proceseve dhe afateve. Zonja Koja kishit ju diçka dhe pastaj zoti Sefa ka kërkuar fjalën!

Znj. M. Koja: Në vijim të asaj që ju sapo thatë zonja Nano, afati i ngritjes së KZAZ-ve në rastin e zgjedhjeve të pjesshme është një afat i përcaktuar në kod. Vetë legjislatori ka menduar që ky afat të jetë jo më vonë se 10 ditë. Pra, ka gjykuar që një afat jo më shumë se 10 ditë është një afat i nevojshëm dhe i arsyeshëm. Në rastin tonë konkret, ne kemi afruar aq sa është e mundur, pra nuk jemi në 10 ditë, kemi vendosur datën 25, kemi llogaritur gjysmën e kohës, nga data 21 në datën 25, afatin për dorëzimin e propozimeve nga ana e subjekteve politike për ngritjen e KZAZ-ve. Pra, jemi treguar vërtet shumë të kujdesshëm, pikërisht për t'u dhënë atë mundësinë subjekteve për të zhvilluar dhe fushatën elektorale në kohën e përcaktuar në akt. Nisem nga ajo që legjislatori ka përcaktuar, ka menduar që një afat i arsyeshëm është deri në 10 ditë dhe ne e kemi afruar atë në gjysmën e kohës. Këtë doja vetëm të nënvizoja, faleminderit!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Siç e përmendët, do jap dhe pak përgjigje më vonë drejtoreshës. Siç e përmendet dhe më parë ky projektvendim përcakton

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.22.01.2022*

datën e fundit, datën 12 shkurt thatë, në qoftë se do përmbyllem me këto afate siç është përcaktuar këtu, me këto afate do të përmbyllet gjithë regjistrimi edhe gjithë administrimi. Unë mendoj që propozimi jonë ishte më konkret, ishte data 7, por edhe data 12 shkurt do të ishte e nevojshme dhe do t'i shërbente përsëri asaj idesë që ne ngritëm që në fillim, që të kemi sa më shumë kohë për një fushatë elektorale. Po marrim afatin maksimal, të vendosur në këtë projektvendim për të filluar fushatën elektorale dhe mendoj që do t'i shërbente dhe vetë kandidatëve dhe vetë qytetarëve për të pasur një alternativë sa më të mirë. Ndërkohë përsa i përket asaj ç'ka tha drejtoresha në lidhje me afatin që është përgjysmuar, tani e përsëris përsëri, nuk jemi në kushte normale. I marrim dhe ne përsipër përgjegjësitë tona, marrim dhe ne përsipër duke konsideruar faktin që jemi në një situatë jonormale me zgjedhje të pjesshme vendore dhe normalisht afatet janë këto. Mendoj që edhe ne duhet të bëjmë detyrën tonë, edhe ne duhet të jemi në shërbim të një procesi të rregullt dhe administrimit cilësor të këtyre zgjedhjeve. Normalisht ne nuk na duhen 5 ditë për të paraqitur personat të cilët do jenë anëtarë të KZAZ-së dhe normalisht ne mendojmë që edhe subjektet e tjera zgjedhore mendoj që janë në të njëjtën frymë bashkëpunimi me propozimin tim. Mendoj që këto afate të shkurtohen në një kohë sa më të shkurtër për t'u dhënë mundësi realisht kandidatëve për të qenë pjesë dhe për të shpalosur alternativën e tyre. Dy javë, ju e dini shumë mirë, ka bashki që kanë nga 300 mijë banorë, 230 mijë zgjedhës Bashkia e Durrësit. Dy javë fushatë elektorale, kandidati nuk orientohet dot, jo më të shpalosë alternativë. Unë mendoj që kjo kërkon sakrificë nga të gjitha palët, ndaj edhe ne si parti politike, jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, të mos marrim afate kot për qëllime proceduriale, por t'u japim mundësi zgjedhësve që të kenë një alternativë edhe të shohin alternativën për të cilën do të votojnë, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*


Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Sefa! Atëherë edhe njëherë po i drejtohem administratës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nëse kanë diçka për të shtuar, para se ne të kalojmë në votim sepse, le të themi, argumentet u paraqitën qoftë nga anëtarët e Komisionit Rregullator, qoftë nga përfaqësuesit e partive politike. Sigurisht unë personalisht i mbetem të njëjtit mendim dhe qëndrim që janë të gjitha procese të nevojshme, të domosdoshme, të përcaktuara në afatet më të ngushta të mundshme. Janë procese, që nuk mund të kapërcehet apo të anashkalohet asnjëri prej tyre dhe në kuadër të kohës së nevojshme për ta kryer një proces është zgjedhur afati më i shkurtër. Megjithatë ky është mendimi im. Po, zonja Koja!

Znj. M. Koja: Atëherë thjesht sjell në vëmendje që afati 10-ditor që citova më lartë, i referuar në kod, bën fjalë pikërisht për zgjedhje të pjesshme, se mbase nuk isha e qartë. Pra, legjislatori ka përcaktuar afatin 10-ditor duke vlerësuar zgjedhjet e pjesshme dhe sot jemi në datën 22. Ne kemi vendosur datën 25, afatin për të dërguar partitë politike propozimet e tyre. Unë mendoj që realizimi i një procesi cilësor, një vlerësim cilësor i kandidaturave të propozuara për anëtarë të KZAZ-ve nga ana e KQZ-së, vlerësimi i papajtueshmërisë, vlerësimi i plotësimit të kriterëve, pastërtia e figurës dhe mbi të gjitha trajnimi i tyre, që është detyrim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të realizohet i gjithi brenda maksimumi 48 orëve, që ne do të përpiqemi që këtë afat ta afrojmë sa më shumë të jetë e mundur. Kjo është logjika pse kemi përcaktuar këto afate, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Koja! Zoti Çaka!

Z. D. Çaka: Faleminderit Kryetare! Zonja Koja e citoi që në këto momente, sot jemi data 22 dhe nuk jemi më as në kushtet e 5-ditëshit që po u vjen partive politike për të propozuar anëtarë apo sekretarë për KZAZ-të, por vetëm 3 ditë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



Ndërkohë unë do të bëja dhe një konstatim tjetër që po shoh në tërësi pjesën edhe të afateve që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pra administrata ka sjellë pranë nesh dhe shoh që ka qenë shumë e kuruar zgjedhja e datave dhe ditëve në të cilat bien këto data. Shoh edhe data të cilat janë ditë jave, pra, jo ditë pushimi. Duhet të kemi parasysh dhe diçka, duhet të jemi të kujdesshëm, besoj dhe administrata paska qenë dhe e lavdëroj për këtë, shumë e kujdesshme që ka zgjedhur data që të mos bien në ditë pushimi. Duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe ne të gjithë kur t'i ndryshojmë, nëse do t'i ndryshojmë, nëse do të biem dakord, sepse çdo ditë që shtyhet, mundet të shtyjë me më shumë afate, afatet pasardhëse. Në qoftë se ne do shtynim një ditë, një datë që mund të jetë ditë e premte, do na shtynte 3 ditë afatin e depozitimit të ankimeve, kërkesave. Duke qenë se janë afate procedurale, do të shtyhen në ditën e parë të punës, prandaj edhe ju si përfaqësues të partive politike, unë personalisht ju them që t'i shohim më me objektivitet. Një ditë që mund të shtyhet, unë shoh afate që ka ditë të premte këtu, në qoftë se ne një ditë do ta shtyjme, do na duhet që 3 ditë të shtyjme çdo gjë nga pas dhe mund të futemi në një *ceircuit* që mund të na krijojë më shumë probleme.

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çaka! Besoj i mbyllëm diskutimet për këtë pikë. Kalojmë në votimin e pikës 2 duke patur parasysh propozimin e zotit Sefa. Atëherë votojmë propozimin e zotit Sefa për datën 7 shkurt, si datë e fillimit të fushatës zgjedhore, në vend të datës 19 shkurt!

Kush është dakord me propozimin e zotit Sefa?

Pro: *S'ka*

Kundra: *5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)*

Rrëzohet propozimi i zotit Sefa!

Atëherë votojmë pikën 2 sikundër është sjellë nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord me pikën 2 në përmbajtje sipas propozimit?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Kalojmë tek pika 3. Është detyrimi i zyrës së Gjendjes Civile në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për hartimin e listave të zgjedhësve dhe shpalljen e tyre, paraprakisht dua të them që ky është afat ligjor, 5-ditëshi nga dita e dekretimit. Kemi diskutime për pikën 3? Nëse jo, kalojmë në votim. Po, ndjesë, zoti Çaka!


Z. D. Çaka: Doja të bëja thjesht një propozim duke qenë se u referohemi afateve dhe duke qenë se janë zgjedhje të pjesshme, do të sugjeroja që në fjalinë e dytë, atje ku themi “brenda 48 orëve nga përfundimi i përditësimit, kryetarët e njësisve të qeverisjes vendore miratojnë”, të bëjmë një citim, pra “kryetarët e njësisve të qeverisjes vendore, në të cilën zhvillohen zgjedhjet e pjesshme”.

Z. M. Çakaj: Më fal, por nëse ndërhyjmë aty, i bie të ndërhyjmë dhe në fjalinë e parë “Zyrat e Gjendjes Civile në bashkitë ku do të zhvillohen..” kështu që, nga fryma e aktit del qartë që bëhet fjalë për këto bashki. Kështu që unë jam në rregull me propozimin e administratës.

Znj. I. Nano: Zonja Koja, ju lutem, në mos gaboj është pikërisht Kodi Zgjedhor që përcakton këto afate posaçërisht për zgjedhjet.

Znj. M. Koja: Propozimi i zotit Çaka me sa kuptova ka të bëjë me cilësimin. Ka qenë një dilemë që ne e patëm gjatë hartimit dhe nuk preferuam ta shkruajmë në çdo pikë, përse kohë siç thotë zoti Çakaj, është në frymën e vendimit dhe e eliminuam për të mos ngarkuar aktin.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



Znj. I. Nano: Faleminderit! I qëndroni propozimit ta votojmë?

Z. D. Çaka: Jo nuk ka problem! Dukë qenë se është frymë e përgjithshme dhe të gjithë bien dakord dhe unë tërhiqem.

Znj. H. Vukaj: Edhe titulli e përcakton se cilat janë ato bashki normalisht edhe gjendja civile e atyre bashkive merr përsipër detyrën.

Z. D. Çaka: Dakord!

Znj. I. Nano: Në rregull! Votojmë pikën 3 sipas propozimit të administratës.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Pika 4 lidhet me paraqitjen nga partitë politike të kandidatëve për anëtarë, sekretarë në KZAZ-të, citohen në këtë pikë të gjitha KZAZ-të, në 6 bashkitë. Datën 25 janar për paraqitjen, që sikundër thamë është 3 ditë nga sot dhe 48 orë për verifikimin nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Diskutime për këtë pikë? Zoti Logu dhe zoti Sefa, duke qenë që është hera e parë që jeni në mbledhjet e Komisionit Rregullator. Sipas rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator, nëse jeni të dy, pra dhe përfaqësuesi dhe zëvendësuesi, vetëm njëri prej jush do të duhet të flasë kështu që meqenëse ka folur zoti Sefa, mundet ta vijojë zoti Sefa argumentin, faleminderit!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Ne e kishim në lidhje me afatet zonja Kryetare. Meqë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe administrata kërkon patjetër një afat

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



48 orë, duke pasur në konsideratë dhe faktin që ne sapo kaluam zgjedhjet e përgjithshme dhe anëtarët e KZAZ-së ishin propozime të partive politike, ne mendojmë që ky afat është i tepërt dhe zgjat më shumë ngritjen e KZAZ-ve në bashkitë përkatëse. Mendojmë që partitë politike i kanë të gjitha mundësitë dhe asetet njerëzore për të mbushur detyrimin e tyre, dakord jemi me datën 25 janar për sa kohë që duhen dhe një sërë dokumentesh nga personat që do të propozohen si anëtarë të KZAZ-ve, se siç e dini duhet edhe diploma e noterizuar dhe normalisht kërkohet një ditë pune dhe është diçka normale. Ndërkohë që mendoj që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund ta shkurtojë pak afatin e 24 orëve në lidhje me këtë dhe të marrë vendim Komisioneri për ngritjen e KZAZ-ve, sepse sa më shpejt të ngrihen KZAZ-të aq më shpejt fillon administrimi zgjedhor, faleminderit!

Z. M. Çakaj: Atëherë, ashtu siç e sqaroi dhe Sekretari i Përgjithshëm, por edhe drejtoresha juridike, kohëzgjatja që merr Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për dy ditë ka të bëjë posaçërisht së pari: -

- a. me verifikimin e dokumentacionit që paraqesin të gjithë anëtarët e KZAZ-ve të propozuara, dhe
- b. me verifikimin e gjendjes gjyqësore, e cila siç u parashtrua dhe më parë nuk kryhet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, por jemi të detyruar t'i drejtohem Drejtorisë së Burgjeve.

Kështu që minimalisht korrespondenca institucion me institucion do të marrë të paktën 24 orë. Kështu që në këto kushte është menduar dhe është diskutuar dhe me kolegët e tjerë që koha prej jo më shumë se dy ditësh, ose 48 orë, do të jetë e nevojshme për miratimin nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, e përbërjes së KZAZ-së. Më fal, çfarë ndodh, t'ju drejtoj një pyetje? Çfarë ndodh nëse ndonjë nga anëtarët e propozuar të KZAZ-së ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë, qoftë se nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit, apo qoftë në rastin

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




kur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve marrim një informacion se ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë? Atëherë brenda këtij 48-orëshi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve komunikon me partinë politike, e cila ka të drejtë të caktojë përfaqësues të KZAZ-së, të marrë përsipër zëvendësimin e tij, apo jo? Kështu që në këto raste mos t'i vëmë edhe ju edhe ne vetes afate, të cilat mund të na çojnë në një situatë që të ngelemi pa anëtarë KZAZ-je. Pra, situata juridike nga zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 prill, deri në datën e propozimit, në datën 25 janar është..., nuk mund ta dimë atë se si është situata juridike. Atë do ta verifikojmë në bazë të dorëzimit të dokumentacionit dhe në bazë të koorrespondencës që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të ketë me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Znj. I. Nano: Të mos harrojmë edhe një fakt që ne si zyrtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e vumë re, e pamë në zgjedhjet e fundit parlamentare. Ky institucion ka administruar dhe ka organizuar jo pak zgjedhje ku afatet, data "x" apo data "y" nënkupton orën 12 të natës për shumë subjekte politike dhe subjekte zgjedhore. Të mos shkojmë më tej, por vetëm në zgjedhjet e përgjithshme të 25 prillit. Le të mos marrim tashmë orën e depozitimit të dokumentacionit nga partitë politike, por është 12 pa 1 ose 12 e 1 që do të thotë janë vetë partitë politike që shkojnë në *dead line*. Pra, i humbet një gjysmë dite Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vetëm nga ky afat. Pra, unë theksoj edhe njëherë vendosja e afateve të tilla jo më vonë se, do të thotë që është një afat maksimal, nëse bëhet më herët aq më mirë. Kjo do të thotë që do të bëhet ky verifikim brenda dy ditëve dhe janë jo pak sikundër tha Sekretari i Përgjithshëm, janë 13 KZAZ. Janë mbi njëqind anëtarë të KZAZ-ve që do të duhet të verifikohen.

Propozimi i zotit Sefa ishte data 26 janar, atëherë hedhim për votim propozimin, në fjalinë e fundit Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton përbërjen e KZAZ-ve jo më vonë se data 26 janar 2022.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



Kush është dakord me propozimin?

Pro: S'ka

Kundra: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Rrëzohet propozimi i zotit Sefa!

Votojmë pikën 4 sipas përmbajtjes së propozuar nga administrata.

Atëherë të nderuar kolegë kush është dakord me pikën 4?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Kalojmë në pikën 5. Bëhet fjalë për të drejtën dhe detyrimin e partive politike për të paraqitur anëtarët e KQV-ve për depozitimin e tyre në KZAZ sipas afatit të përcaktuar. Kemi depozitimin e emrave pra, propozimin për anëtar të KQV-së dhe afatin tjetër për emërimin e anëtarëve të KQV-së. Zonja Koja, besoj dhe ky është një afat ligjor?

Znj. M. Koja: Po është një afat edhe ky i përcaktuar!

Znj. I. Nano: I përcaktuar! Pra, nuk është një afat që është përpunuar nga ana juaj sipas logjikës së veprimeve, por është një afat ligjor.

Znj. M. Koja: Nëse mund të shtoj! Afati i KZAZ-ve është shumë i rëndësishëm se lidhet pikërisht me regjistrimin e kandidatëve. Ndërsa më pas, i ngritjes së komisioneve të qendrave të votimit apo i grupeve të numërimit të votave, janë procese që vijnë, por nuk janë detyrimisht të lidhur me afatet për të regjistruar subjektet. Pra, KZAZ-ja ishte momenti më i rëndësishëm, i cili duhet të konstituohet sa më parë.

***Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU***

Znj. I.Nano: Në rregull, faleminderit! Diskutime lidhur me këtë pikë? Nuk ka diskutime. Kalojmë për votimin e pikës 5.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet pika 5!

Kalojmë tek pika 6. Bëhet fjalë për depozitimin nga ana e partive politike të anëtarëve të GNV-ve në KZAZ dhe vendimmarrjen e KZAZ-ve për anëtarët e grupeve të numërimit të votave. Diskutime për këtë pjesë, për këtë pikë, pikën 6? Nëse jo, kalojmë në votim.

Kush është dakord me pikën 6?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Kalojmë në pikën 7! Pika 7 dhe pika 8 do thoja janë analoge të njëra-tjetrës sepse bëjnë fjalë qoftë për partitë politike, qoftë për komitetet nismëtare që paraqesin kërkesën për regjistrim, por me një ndryshim. Në rastin e bashkive që kanë më tepër se një KZAZ, kërkesa drejtohet në KQZ. Në rastin e bashkive që kanë vetëm një KZAZ, kërkesa drejtohet në KZAZ-në përkatëse. Le ta konsiderojmë një diskutim të përbashkët për të dyja pikat. Zoti Sefa, po!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zonja Kryetare! Qëndrimi ynë është që ky afat është i tepërt. Partitë politike janë në dijeni që kanë zgjedhje dhe janë në dijeni të dokumentacionit të nevojshëm ligjor që kërkon KQZ-ja për regjistrimin si parti politike. Duke filluar që nga data 24 ka të gjithë mundësinë për të grumbulluar dokumentacionin ligjor dhe për të bërë gati të gjithë shkresën. Ne mendojmë që data 28 si datë fillimi, meqë lidhet me ngritjen e KZAZ-ve, lidhet me 27 dhe 28, lidhet me ngritjen e KZAZ-ve. Unë mendoj që data 31 janar

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



është tepër, mendoj që data 29 do të ishte shumë mirë. Për sa kohë kemi datën 28, 29 janë 48 orë. 48 orë për partitë politike për të paraqitur gjithë dokumentacionin ligjor, unë mendoj se janë të bollshme. Personat që kërkojnë të regjistrohen në bazë të komiteteve nismëtare kanë të gjithë mundësinë për të filluar procedurën që sot, sepse ne sot jemi në proces zgjedhor praktikisht. Të fillojnë procedurën që sot, identifikimin e njerëzve dhe në momentin që bëhet konstituimi i KZAZ-ve fillojnë dhe procedurat ligjore për regjistrimin e tyre. Prandaj unë jam me idenë, zonja Kryetare dhe anëtarë të Komisionit, që afati 31 janar është i tepërt. Ne kërkojmë mirëkuptim dhe bashkërendim me ju dhe me administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sepse nuk jemi në kushte normale. Në qoftë se do të ishim në kushte normale, e kishim shumë të thjeshtë. Partitë politike në vend që të kërkojnë kohë sa më të shkurtër, kërkojnë kohë sa më të gjatë.

Znj. I. Nano: Atëherë zoti Sefa, besoj që po biem në emërues të përbashkët për faktin që data 27 janar ishte data e verifikimit nga ana e KQZ-së dhe e anëtarëve të KZAZ-së, që do të thotë...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Për sa kohë që u vendos nga ky komision...

Znj. I. Nano: U vendos dhe data 28 është e nesërmja e saj, 48 orë. E di çfarë ndodh në fund të 48-orëshit? Është fundi i ditës së shtunë. Është e diela më pas, kështu që në çdo rast dhe ta kishe vënë 48 orë, do të shkonte afati deri të hënën. Pra, nisemi nga përvojat, prandaj dhe zoti Çaka pak më herët tha që është kuruar në detaje lidhur me afatet, ky vendim sa i përket kësaj çështjeje.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Unë nuk mendoj që këto 30 ditë që kanë ngelur për zgjedhjet, a 40 ditë do kemi pushime, kështu që?

Znj. I. Nano: Nuk mund të paragjykojmë, është afat që sipas Kodit të Procedurave Administrative, nëse fundi afatit bie një ditë pushimi, shkojmë në afatin e ardhshëm që është e hëna në këtë rast. Po zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Në rast se marrim, sigurisht e mirëpresim e gjykojmë dhe e vlerësojmë me gjithë objektivitetin e mundshëm kërkesën tuaj. Por, në rast se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të vihet, pra ka një kërkesë për regjistrim si subjekt zgjedhor dhe do të detyrohet t'i drejtohet gjykatës së rrethit gjyqësor përkatës për të verifikuar qoftë edhe dokumentin bazë që parashikon Kodi Zgjedhor, që është vërtetimin e regjistrimit në gjykatë. A mund t'i drejtohet dot ditën e shtunë apo ditën e diel? Pra, janë afate që nuk varen dot nga KQZ-ja.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Tani unë nuk e di sa herë i është drejtuar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gjykatës për të vërtetuar vërtetimin e lëshuar nga vetë gjykata apo jo? Këtë mund ta bëjë kur ta mendojë Komisioneri, kur ta mendojë Komisioni...

Z. M. Çakaj: Ajo thotë vetëm në ditë pune!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Partitë politike kanë detyrë të marrin vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nga regjistri i partive politike, vërtetim zyrtar të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Z. M. Çakaj: Absolutisht po!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Për të cilën tregon që cila parti është e regjistruar dhe kush është personi i autorizuar për të drejtuar këtë parti dhe normalisht pastaj Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në qoftë se..., dhe Komisioneri, në qoftë se ka

pretendime, ka të gjithë afatin ligjor për t'iu drejtuar dhe kur e mendon ai të përshtatshëm.

Z. M. Çakaj: Pikërisht në vijim të kësaj është përcaktuar afati 48 orë për të verifikuar gjithë dokumentacionin e paraqitur nga subjektet. Si?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Edhe njëherë! Projektvendimi thotë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton kërkesat.

Z. M. Çakaj: Kryen procedurën e tij Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe ka afatin 48 orë. Në këto 48 orë edhe nëse mungon ndonjë dokument, komunikon me subjektin përkatës, i cili kërkon të regjistrohet dhe në bazë të komunikimit dhe dokumentacionit të përcjellë, vendos. Urdhëro!

Znj. I. Nano: Zoti Sefa, nga komunikimi me administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në rastet kur ka afate fundore, ato nuk janë vënë në ditët e pushimit. Ky është argumenti për këtë pikë. Pra, 28 është ditë e premtë dhe nëse do të vihej 29 apo 30, detyrimisht shkonte 31. Pra, ky është argumenti për datën 31.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Në qoftë se është ky argumenti, është diskutim tjetër ai...

Znj. I. Nano: Absolutisht ky është argumenti për datën 31, unë ua thashë më përpara, pra nëse do ta vendosnim 29, automatikisht shtyhej për datë 31.

Z. D. Çaka: Prish pastaj gjithë zinxhirin.

Znj. I. Nano: Gjithë zinxhirin që flet për 24-orësha. Të lutem, nuk do t'u hyjmë gjithë procedurave që ndodhin në çdo 24-orësh. Po themi si afat, është dita e premte, deri ditën e hënë, që e theksoj dhe njëherë, nëse do të qe vendosur afati 29 apo në 30, automatikisht do të shkonte 31. Atëherë, ju keni propozimin për në datën 29. I qëndroni propozimit ta votojmë, apo tërhiqeni nga propozimi pas këtij argumenti?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: I qëndroj propozimit.

Znj. I. Nano: Në rregull! Zonja Vukaj, po!

Znj. H. Vukaj: Në kushtet e këtij shqetësimi të zotit Sefa, më lind e drejta dhe detyrimi në të njëjtën kohë, t'i drejtohem administratës për transparencë dhe në të njëjtën kohë për mundësinë, ose për të na sqaruar, nëse ky propozim do të vijonte me miratim, çfarë do cënonte? Përveç këtyre argumenteve që sapo sollëm, që bie ditë e premte dhe e dimë se si përlllogariten afatet mbi bazën e logjikës dhe parimeve të Kodit Civil, apo administrativ dhe ndoshta, a ka ndonjë hapësirë që do ta toleronte, apo ju e shikoni të domosdoshëm që ky afat cedon legjitimitetin e proceseve verifikuese që keni në vijim? Faleminderit!

Znj. M. Koja: Faleminderit për pyetjen zonja Vukaj! Siç u diskutua më herët dhe nga zonja Nano dhe nga diskutimet e tjera të anëtarëve, afati i përcaktuar këtu është i mirëmenduar, pikërisht për të mos cënuar si verifikimin e dokumentacionit, pra ai të bëhet i plotë, i gjithanshëm, të jetë i kujdesshëm, por edhe në respektim të përcaktimit të Kodit të Procedurave Administrative. Pyetja që do të ngrija është kjo. Nëse unë, administrata, apo ju vendosni, që datat do të jenë 28 dhe 29 janar, nëse në datën 31 janar në KQZ depozitohet një kërkesë për regjistrim, çfarë ndodh? Detyrimisht do të pranohet, sepse është brenda afateve

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

ligjore të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative. Pra, detyrimisht do të shkojmë tek data 31. Janë afate të diktuar nga kalendari dhe nga Kodi i Procedurave. Ne jemi përpjekur t'i afrojmë sa më shumë të jetë e mundur, por gjithnjë duke pasur në fokus cilësinë e procesit, faleminderit!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Në qoftë se mundem, zonja Kryetare?

Znj. I. Nano: Po, zoti Kaziaj!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Unë e thashë dhe më parë shtesën që bëra në fillim të fjalës time, që ky akt, pasi na është komunikuar zyrtarisht nga ana e KQZ-së, është marrë në shqyrtim pikë për pikë nga ana e subjektit që përfaqësoj dhe gjej dakordësinë me ju dhe me drejtoreshën e KQZ-së. Në të gjitha pikat e veta ku parashikohen afate, afatet janë ngushtësisht të imponuara nga ligji dhe nga procedura. Tani, me gjithë respektin për kolegun Sefa, nuk mundet ta orientojmë këtë debat në këtë Komision, vetëm me interesa të një subjekti politik. Këtu po flitet për organizimin e zgjedhjeve, flitet për persona, apo subjekte, individë apo subjekte që nuk kanë akses, të themi, ose struktura të mirëfillta juridike, siç mund t'i kenë subjektet tona. Në këto rrethana do të duhet të punojnë vetëm kandidati i pavarur, ose një subjekt politik, i cili është një subjekt relativisht i vogël politik dhe normalisht i duhen dhe koha dhe afatet e të gjitha, për të qenë në përputhje me ato që janë kërkesat ligjore të Kodit Zgjedhor, për procesin zgjedhor.

Znj.I.Nano: Faleminderit, zoti Kaziaj! Më besoni, edhe për ju që jeni subjekte më të mëdha dhe më të organizuara do të jetë shumë e vështirë të përmbushni gjithë detyrimet në këto afate. Megjithatë, nuk kemi pasur këtë parasysht kur është

hartuar, nuk është pasur kjo parasysh. Zoti Çakaj, para se të kalojmë në votim!
Faleminderit!

Z. M. Çakaj: Atëherë, me të drejtë në temën e shtruar për diskutim u bashkuan të dy pikat, pra pika 7 dhe pika 8, pasi bëhet fjalë së pari, në vijim dhe të asaj që konstatoi me të drejtë zoti Kaziaj. Bëhet fjalë, kemi një proces zhvillimi të zgjedhjeve të pjesshme edhe këtu interesin nuk mund ta paragjykojmë, interesin mund ta ketë kushdo. Kushdo subjekt zgjedhor, mund ta kenë komitete nismëtare, mund ta kenë kandidatë të pavarur, të cilët në respekt të nenit 69 dhe nenit 70 Kodit Zgjedhor, arrijnë të mbledhin nënshkrimet dhe e paraqesin sipas rastit, kërkesën e tyre për regjistrim, ose në KZAZ, për tre bashkitë kur janë me një KZAZ, ose në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për bashkitë ku ka më shumë se një KZAZ. Po të shihni me vëmendje, në këto dy nene të cilat sapo referova, parashikohet dhe një procedurë verifikimi e nënshkrimeve. Kështu që koha së pari, afati i paraqitjes dhe së dyti, koha e verifikimit të nënshkrimeve sipas rastit në KZAZ, apo në KQZ, është minimumi i mundshëm në mënyrë që KQZ-ja më pas, të procedojë në respekt të kërkesave të kodit, me vijimin e regjistrimit të këtyre subjekteve. Kështu që unë besoj, duhet të marrë në konsideratë dhe ky fakt, faleminderit!

Znj. I. Nano: Zoti Çakaj, faleminderit! Do të kalojmë në votim pas diskutimeve, edhe pse diskutimin e bëmë të përbashkët për pikën 7 dhe 8, votimin duhet ta bëjmë në mënyrë të veçantë për secilën nga pikat. Atëherë, propozimi ishte për të vendosur nga data 28 deri në datën 29, në pikën 7 dhe po kështu nga data 28 deri në datën 29, në pikën 8. Kështu që kemi propozimin e zotit Sefa për pikën 7.

Kush është dakord me këtë propozim?

Pro: *S'ka*

Kundra: *5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)*

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.22.01.2022*

Nuk miratohet propozimi!

Atëherë, kalojmë në votimin e pikës 7, sipas përmbajtjes së ardhur nga administrata e KQZ-së.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë tek votimi i propozimit të zotit Sefa, për pikën 8. Pra, për afrimin e afatit nga data 31, në datën 29 janar?

Kush është dakord?

Pro: S'ka

Kundra: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Rrëzohet propozimi i zotit Sefa!

Kalojmë në votimin e pikës 8 sipas përmbajtjes së ardhur.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet pika 8 e projektvendimit!

Kalojmë në pikën 9. Kemi rastin e kërkesës për regjistrim të koalicioneve zgjedhore. Edhe këtu është ndjekur një afat minimal. Pra, 24 orë nga miratimi i kërkesave, i gjithë kërkesave për regjistrimin e partive dhe komiteteve nismëtare, dhe afati tjetër 24 orë për Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve. Sepse sikundër tashmë është e ditur dhe e njohur nga Kodi Zgjedhor, koalicionet regjistrohen si subjekte zgjedhore, pasi janë regjistruar partitë politike, të cilat mund të jenë pjesë të koalicionit. Kemi diskutime për këtë pikë? Nëse jo, kalojmë në votimin e pikës 9!

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

Kundra: **S'ka**

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në pikën 10. Janë dokumentet e kandidimit. Afati është nga data 6 deri në 9 shkurt. Verifikimi qoftë në KQZ, qoftë në KZAZ, në varësi se ku depozitohen apo paraqiten, është jo më vonë se 24 orë nga paraqitja. Është i njëjti proces që e dimë, kthimi nëse ka parregullsi, apo nëse ka mangësi kthimi për plotësim. Prapë një 24-orësh u lejohej subjekteve për të riparaqitur dokumentet e plotësuara. Lidhur me këto afate? Po, zoti Sefa!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Nga data 6 deri në 9 shkurt, ky afati 1-javor nga data 31, që i bie e hënë deri në datën 6, që i bie prapë e hënë, për çfarë shërben? Jam dakord për komitetet për mbledhjen e firmave, por mendoj që duke pasur në konsideratë dhe numrin e zgjedhësve dhe në qoftë se ka kandidatë që mendojnë që të regjistrohen si të pavarur...

Znj. I. Nano: Zoti Sefa, e kuptova! Do t'ju lutesha t'i hidhni një sy edhe njëherë pikës 7 dhe 8. Data 31 është afati për paraqitjen e kërkesës për regjistrim, por të mos harrojmë që kemi procese të tjera pas kësaj, që mund të jetë kthim për plotësim dokumentesh, që mund të jetë riparaqitje. Pra, ke dy 24-orësha të tjerë, pastaj ke koalicionet zgjedhore. Pra, nuk është bosh, nuk është një periudhë nga data 31 në datën 6. Lutem dhe njëherë, shihni pikën 7 dhe pikën 8 çfarë ndodh pas datës 31.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Janë afate 24-orëshe. Unë po të them të fillojë nga data 31 plotësimi i dokumentacioneve për kandidatët. Fillojmë nga data 3 dhe i lëmë mundësi për ta bërë. Është data 2, data 3, data 4...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

Znj. I. Nano: Në rregull, do të bëjmë matematikë më duket. Atëherë, datë 31 është afati i paraqitjes së partive, të kërkesës së partive dhe komisioneve nismëtare. 24 orë ka KQZ-ja për t'u kthyer këtyre subjekteve për plotësim dokumentacioni, 24 orë të tjera kanë subjektet për t'i plotësuar dokumentet dhe 24 orë të tjera ka Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për të miratuar kërkesat për regjistrim. Mbaruan partitë, vijojnë koalicionet mbas kësaj, kanë dhe ato 24 orë mbas datës 3. Data 5 është data për miratimin nga Komisioneri, ja shkoi data 5. Data 6 fillon afati tjetër. Është aritmetikë e thjeshtë. Data 6? Le t'i sjellin po të duan në datën 6. Pra, ja ku ju'a kemi marrë një ditë, por deri në datë 9 i kemi lënë. Pra, është një afat për dokumentet e kandidimit dhe ju e dini që dokumentet e kandidimit nuk janë pak. Pra, që ta tërheqim këtë afat para datës 6, besoj është e qartë që nuk ka mundësi. Diskutim tjetër nga kolegët? Data 6-9 si afat i paraqitjes së dokumenteve të kandidimit dhe marrja e vendimeve nga KQZ-ja, apo KZAZ-ja përkatësisht.

Kush është dakord me pikën 10?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Miratohet me 5 vota pro!

Kemi pikën 11. Paraqitjen e kërkesës për akreditim të vëzhguesve shqiptarë në KQZ dhe për vëzhguesit e huaj dhe afatin e akreditimit të tyre. Diskutim për këtë çështje? Nëse jo, kalojmë në votimin e pikës 11.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 12. Është paraqitja e kërkesave për akreditim nga ana e subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje dhe akreditimi i tyre. Kemi ndonjë diskutim?

Kalojmë në votimin e pikës 12, kush është dakord?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Vijmë tek pika 13. Lidhet me detyrimin e kryetarëve të bashkive për paraqitjen e listës së objekteve ku do të vendosen qendrat e votimit, edhe ajo është lënë për javën që vjen, data 27. Komentë, diskutime, propozime për shtesa, ndryshime? Nëse jo, kalojmë në votimin e pikës 13.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 14. Detyrimi i prefektëve të qarqeve ku ndodhen njësitë e vetëqeverisjes vendore që do zhvillohen zgjedhjet. Pra, qarqet Shkodër, Tiranë, Durrës, Dibër, Fier, për të paraqitur listën e objekteve që përmbushin kushtet e parashikuara në ligj për VNV-të, pra për vendnumërimin e votave, edhe kjo është me një afat deri në 27 janar. Kemi diskutime? Nëse jo, kalojmë për votim.

Kush është dakord me pikën 14?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 15. Rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 3 ditëve të fundit, para datës së zgjedhjeve, përfshirë dhe datën e zgjedhjeve, deri në orën e mbylljes së votimit. Kemi diskutime? Jo! Kalojmë në votim.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet pika 15!

Pika 16, gjithashtu një detyrim i kryetarëve të bashkive, për të përcaktuar vendet publike ku do të bëhen afishimet e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore. Diskutime lidhur me këtë çështje?

Kalojmë në votimin e pikës 16, kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 17. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 18. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet pika 18!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit, “Për miratimin e disa afateve proceduriale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar, në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”.

Votojmë në tërësi projektvendimin, kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, sapo miratuam vendimin për miratimin e afateve proceduriale.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.22.01.2022*

Në këtë mbledhje miratuam edhe një ndryshim në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, duke vendosur një afat të ri për ankimet ndaj akteve të KZAZ-së dhe disa akteve të Komisionerit, nga 3 ditë në 24 orë, në rastin e zgjedhjeve të pjesshme. Duke qenë se nuk kemi çështje të tjera për diskutim, e deklaroj të mbyllur mbledhjen e Komisionit Rregullator, faleminderit!

Vendimi nr. 2

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

